

Në bazë të nenit 28 paragrafi (2), nenit 30 paragrafi (1) dhe nenit 45 paragrafi (1) pika (1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 208/24 dhe 16/25), Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës në përbërje: Mr. Borçe Razmoski–Kryetar, Mr. Malinka Siljanovska Nikolliq, Aleksandar Trgačevski, Nikolla Trajčevski dhe Valon Elezi - anëtarë, duke vepruar në procedurën e iniciuar sipas detyrës zyrtare me konkluzionin PK nr. 09-58/2 të datës 12.03.2025 kundër Korporatës Jageo, me seli në 3F, 233-1, Baokiao Roud, rajoni Ksindian., Nju Taipei Siti, Tajvan, Republika e Kinës, e përfaqësuar nga Shoqëria e avokatëve Papazoski dhe Mishev nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 25.07.2025 solli këtë

AKTVENDIM

1. Konstatohet se Korporata Jageo, me seli në 3F, 233-1, Baokiao Roud, rajoni Ksindian., Nju Taipei Siti, Tajvan, Republika e Kinës, e përfaqësuar nga Shoqëria e avokatëve Papazoski dhe Mishev nga Shkupi, edhe pse në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ka qenë e obliguar që Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës t'i dorëzojë njoftim për përqendrim para zbatimit të tij, respektivisht para datës 15.06.2020, kur është dorëzuar Vërtetimi për bashkim te Sekretari i shtetit, ndërsa pas lidhjes së Marrëveshjes dhe planit për bashkim më 11 nëntor 2019, e njëjta në periudhën e theksuar nuk ka parashtruar njoftim për përqendrim, me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 60 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës për çka i shqiptohet sanksion - gjobë në shumë prej 307.500 denarë që paraqet 0,0004% nga vlera e të ardhurave të përgjithshme vjetore të Korporatës Jageo të realizuara në vitin 2019 (të llogaritura në përputhje me nenin 16 të Ligjit) si vit i cili i paraprin përqendrimit.

2. Konstatohet se Korporata Jageo, me seli në 3F, 233-1, Baokiao Roud, rajoni Ksindian., Nju Taipei Siti, Tajvan, Republika e Kinës, e përfaqësuar nga Shoqëria e avokatëve Papazoski dhe Mishev nga Shkupi edhe pse në përputhje me nenin 18 paragrafi (1) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës nuk kanë guxuar ta zbatojnë përqendrimin para datës 25.02.2025, si ditë kur Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës ka sjellë aktvendim me të cilin konstatohet se përqendrimi në fjalë është në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës, Korporata Jageo e ka zbatuar përqendrimin më 15.06.2020, kur është dorëzuar Vërtetimi për bashkim te Sekretari i shtetit, me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 60 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës për çka i shqiptohet sanksion - gjobë në shumë prej 3.444.000 denarë që paraqet 0,0046% nga vlera e të ardhurave të përgjithshme vjetore të Korporatës Jageo të realizuara në vitin 2019 (të llogaritura në përputhje me nenin 16 të Ligjit) si vit i cili i paraprin përqendrimit.

3. Për kundërvajtjet nga pika 1) dhe 2) të këtij vendimi, Korporatës Jageo, me seli në 3F, 233-1, Baokiao Roud, rajoni Ksindian., Nju Taipei Siti, Tajvan, Republika e Kinës, e përfaqësuar nga Shoqëria e avokatëve Papazoski dhe Mishev nga Shkupi, i shqiptohet sanksion i vetëm - gjobë në shumë prej 3.751.500 denarë, që paraqet 0,005% nga vlera e të ardhurave të përgjithshme vjetore të Korporatës Jageo të realizuara në vitin 2019 si vit i cili i paraprin përqendrimit.

4. Gjobën nga pika 3) e këtij vendimi, kryerësi i kundërvajtjes është i obliguar ta paguajë në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit në llogarinë e transaksionit të

pranuesit të urdhëresës: 100-0000000630-95, llogaria pagesore: 840xxx¹ 07337 - gjoba për kundërvajtje të kryera nga fusha në kompetencë të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, me shifër të ardhurash 722139 dhe program 00, pranues i urdhëresës - Ministria e Financave, banka e pranuesit – BPRM dhe deri te Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës të dorëzojë dëshmi/kopje nga pagesa e kryer e gjobës në afat prej 15 ditësh nga pagesa e kryer. Gjoba e papaguar ose gjoba e papaguar në kohë, do të arkëtohet në rrugë të detyrueshme. Padia e shtyn ekzekutimin e vendimit.

Arsyetim

Nga Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: Komisioni) më datë 07.03.2025, deri te Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: KVK) është dorëzuar shkresa nr. 09-58/1 me qëllim që KVK të konstatojë nëse në lëndën e theksuar eventualisht është kryer kundërvajtje nga neni 60 paragrafi (1) pika 1) dhe/ose 60 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

KVK më 12.03.2025 sipas detyrës zyrtare solli konkluzion nr. 09-58/2 për iniciimin e procedurës për kundërvajtje kundër Korporatës Jageo, me seli në 3F, 233-1, Baokiao Roud, rajoni Ksindian., Nju Taipei Siti, Tajvan, Republika e Kinës, (në tekstin e mëtejme: Korporata Jageo) për shkak të mosparashtrimit të njoftimit për përqendrim në përputhje me nenin 15 të Ligjit, që paraqet kundërvajtje nga neni 60 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit dhe për shkak të zbatimit të përqendrimit në kundërshtim me nenin 18 paragrafi (1) të Ligjit, që paraqet kundërvajtje nga neni 60 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit. Me konkluzionin për iniciimin e procedurës për kundërvajtje KVK e obligoi Korporatën Jageo, në përputhje me nenin 40 të Ligjit, të dorëzojë dëshmi se kur është zbatuar përqendrimi (kur është kryer regjistrimi i pronësisë në regjistrin tregtar) me të cilën Korporata Jageo, fiton kontroll mbi Korporatën KEMET, me adresë të selisë në Uan Ist Bouard Bulevard, Apartamenti 500, Fort Lauderdale, FL 33301, SHBA (në tekstin e mëtejme: Korporata KEMET).

Konkluzioni është dorëzuar me letër përcjellëse PK nr. 09-58/3 të datës 12.03.2025.

Me shkresë nr. PK 09-58/4 të datës 12.03.2025 KVK iu drejtua të autorizuarve të Korporatës Jageo me qëllim sqarimin e autorizimin.

Të autorizuarit e Korporatës Jageo dorëzuan shkresë, e jona PK nr. 09-58/5 të datës 18.03.2025.

Më datë 25.04.2025 Të autorizuarit e Korporatës Jageo dorëzuan autorizim (e jona PK nr. 09-58/6).

Me shkresë e jona PK nr. 09-58/7 të datës 05.05.2025 Korporata Jageo u deklarua pas konkluzionit.

Më datë 23.05.2025 KVK solli Njoftim paraprak për gjendjen e vërtetuar faktike PK nr. 09-58/8.

¹ Shënohet shenja e komunës në pajtim me Listën e komunave me shenja në Republikën e Maqedonisë, e cila është pjesë përbërëse e Udhëzimit për mënyrën e evidentimit, shpërndarjes dhe kthimit të të ardhurave publike (Gazeta Zyrtare e R.M. nr. 8/06).

Me shkresë PK nr. 09-58/9 të datës 23.05.2025 Njoftimi paraparak iu dorëzua Korporatës Jageo.

Me shkresë e jona PK nr. 09-58/10 të datës 10.06.2025 Korporata Jageo u deklarua pas Njoftimit paraparak.

Më datë 04.07.2025 KVK solli Njoftim përfundimtar për gjendjen e vërtetuar faktike PK nr. 09-58/11, i cili u dorëzua me shkresë PK nr. 09-58/12 të datës 04.07.2025.

Me shkresë tonë PK nr. 09-58/13 të datës 17.07.2025 Korporata Jageo u deklarua pas njoftimit përfundimtar.

Në bazë të analizës së të dhënave dhe dokumenteve të dorëzuara KVK vërtetoi këtë gjendje faktike:

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit më datë 02.01.2025, ndërsa e plotësuar më 29.01.2025, deri te Komisioni është dorëzuar njoftim për përqendrim nga ana e Korporatës Jageo, me të cilën Korporata Jageo, fiton kontroll mbi Korporatën KEMET.

Komisioni aktvendimin nr. 08-1 me të cilin konstatohet se përqendrimi i theksuar është në përputhje me dispozitat e Ligjit e ka sjellë më 25.02.2025.

Korporata Jageo përqendrimin e ka zbatuar më 15.06.2020, kur është dorëzuar Vërtetim për bashkim te Sekretari i shtetit.

Krijimi i përqendrimit

Në përputhje me nenin 12 paragrafi (1) pika 2) alineja 2 të Ligjit, përqendrimi krijohet me ndryshimin e kontrollit në bazë afatgjate, e posaçërisht si rezultat i fitimit të kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të tërësisë ose pjesëve të një ose më shumë ndërmarrjeve tjera nga një ose më shumë persona të cilët tashmë kontrollojnë të paktën një ndërmarrje.

Korporata Jageo fiton kontroll të drejtpërdrejtë të Korporatës KEMET nëpërmjet bashkimit të Skaj Merxher Sub Ink., shoqëri e themeluar në Delaver në pronësi të plotë të Korporatës Jageo, me Korporatën KEMET, në përputhje me Ligjin e Përgjithshëm për Korporata të shtetit Delaver, dhe fitimin e 100% të aksioneve të Korporatës KEMET nga ana e Korporatës Jageo.

Për nevojat e zbatimit të transaksionit, Korporata Jageo dhe Korporata KEMET kanë nënshkruar marrëveshje dhe plan për bashkim të lidhur ndërmjet Korporatës Jageo, Skaj Merxher Sub Ink. dhe Korporatës KEMET më 11 nëntor 2019 i cili është dorëzuar në shtojcë të njoftimit për përqendrim të dorëzuar deri te Komisioni.

Kushtet për njoftim për përqendrim

Në përputhje me nenin 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit, njoftim për përqendrim deri te Komisioni parashtrohet nëse të ardhurat e përgjithshme vjetore të përbashkëta të të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse, të realizuara me shitjen e mallrave dhe/ose shërbimeve në tregun botëror, e tejkalojnë shumën prej 10 milionë eurosh në kundërvlerë denarë, sipas kursit në ditën e përpilimit të llogarisë vjetore, të realizuar në vitin afarist që i paraprin përqendrimit, me ç'rast të paktën një pjesëmarrës duhet të jetë i regjistruar në Republikën e Maqedonisë dhe/ose të ardhurat e përgjithshme vjetore të përbashkëta të të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse në

përqendrim të realizuara me shitjen e mallrave dhe shërbimeve në Republikën e Maqedonisë e tejkalojnë shumën prej 2,5 milionë eurosh në kundërvlerë denarë.

Në tregun botëror në vitin 2019, Korporata Jageo ka realizuar të ardhura të përgjithshme në shumë prej 1,197,552,391 euro respektivisht 73.625.521.000 denarë. Në Maqedoninë e Veriut ka fituar të ardhura prej 103.497 euro respektivisht 5,687,401 denarë.

Në tregun botëror në vitin 2019, Korporata KEMET ka realizuar të ardhura të përgjithshme në shumë prej 1,232,581,620 euro respektivisht 75,779,118.000 denarë, pa kurrfarë të ardhure të realizuar në Maqedoninë e Veriut.

Në përputhje me të dhënat e theksuara të ardhurat e përgjithshme vjetore të përbashkëta të të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse, të realizuara me shitjen e mallrave dhe/ose shërbimeve në tregun botëror, e tejkalojnë shumën prej 10 milionë eurosh në kundërvlerë denarë, sipas kursit në ditën e përpilimit të llogarisë vjetore, të realizuar në vitin afarist që i paraprin përqendrimit, me ç'rast të paktën një pjesëmarrës është i regjistruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut prandaj Prandaj është plotësuar kushti nga neni 14 paragrafi (1) pika 1) i Ligjit për parashtrimin e njoftimit.

1. Obligimi për njoftim për përqendrim

Në përputhje me nenin 15 paragrafi (1) të Ligjit pjesëmarrësit në përqendrim janë të obliguar që Komisionit t'i dorëzojnë njoftim për përqendrim para zbatimit të tij. Mosparashtrimi i njoftimit për përqendrim në përputhje me nenin 15 paragrafi (1) të Ligjit paraqet kundërvajtje nga neni 60 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 15 paragrafi (3) të Ligjit, njoftim për përqendrim parashtron personi, respektivisht ndërmarrja e cila fiton kontroll mbi tërësinë ose pjesë të një ose më shumë ndërmarrjeve, në këtë rast Korporata Jageo ka fituar kontroll mbi Korporatën KEMET.

Nga kjo që u theksua më lart është e pakontestueshme se ka ekzistuar obligim për Korporatën Jageo që t'i dorëzojë Komisionit njoftim për përqendrim para zbatimit të tij.

Njoftimin për përqendrimin e theksuar deri te Komisioni Korporata Jageo e ka dorëzuar pas zbatimit të përqendrimit.

Korporata Jageo përqendrimin e ka zbatuar më 15.06.2020, ndërsa siç është theksuar më lart njoftimin deri te Komisioni e ka dorëzuar më 02.01.2025, ndërsa e ka plotësuar më 29.01.2025.

Komisioni aktvendimin nr. 08-1 me të cilin konstatohet se përqendrimi i theksuar është në përputhje me dispozitat e Ligjit e ka sjellë më 25.02.2025.

Prandaj, Korporata Jageo si ndërmarrje e cila ka fituar kontroll mbi Korporatën KEMET edhe pse në përputhje me nenin 15 të Ligjit ka qenë e obliguar që Komisionit t'i dorëzojë njoftim për përqendrim pas lidhjes së Marrëveshjes dhe planit për bashkim të lidhur ndërmjet Korporatës Jageo, Skaj Merxher Sub Ink. dhe Korporatës KEMET më 11 nëntor 2019, e para zbatimit të tij respektivisht para 15.06.2020 (kur është dorëzuar Vërtetim për bashkim te Sekretari i shtetit), e njëjta nuk ka parashtruar njoftim për përqendrim në periudhën e theksuar, me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 60 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit.

Korporata Jageo njoftim të plotë për përqendrimin e theksuar deri te Komisioni ka dorëzuar më datë 29.01.2025.

Korporatës Jageo do t'i shqiptohet sanksion për kundërvajtje – gjobë në shumë deri në 10% nga vlera e të ardhurave të përgjithshme vjetore të realizuara në vitin afarist që i paraprin përqendrimit i llogaritur në përputhje me nenin 16 të Ligjit, *respektivisht e ardhura e përgjithshme e cila përbëhet nga shumat e realizuara me shitjen e mallrave të prodhuara në punën e rregullt të ndërmarrjes, si dhe nga shumat nga shërbimet që ndërmarrja i jep në punën e saj të rregullt, ndërsa të realizuara në vitin afarist që i paraprin përqendrimit, pas zbritjes së rabateve (zbritjeve) të shitjes dhe tatimit mbi vlerën e shtuar dhe detyrimeve tjera publike të lidhura drejtpërdrejt me të ardhurat. Nëse njëri nga pjesëmarrësit është ndërmarrje e lidhur në kuptim të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, gjatë llogaritjes së të ardhurave të tij të përgjithshme, të gjitha ndërmarrjet që janë të lidhura në atë mënyrë do të trajtohen si një ndërmarrje, me ç'rast kur llogariten të ardhurat e përgjithshme të ndërmarrjeve të lidhura nuk do të merren parasysh shumat e realizuara nga shitjet e mallrave dhe/ose dhënia e shërbimeve ndërmjet tyre.*

Të ardhurat e përgjithshme të Korporatës Jageo të realizuara në vitin 2019 (të llogaritura në përputhje me nenin 16 të Ligjit) si vit i cili i paraprin përqendrimit arrijnë shumën prej 1,197,552,391 euro respektivisht 73.625.521.000 denarë.

Në përcaktimin e shumës së gjobës, në përputhje me nenin 64 të Ligjit, KVK i merr parasysh peshën e kundërvajtjes, kohëzgjatjen e kundërvajtjes dhe shkallën e cenimit të konkurrencës dhe pasojat e shkaktuara nga kundërvajtja.

Gjatë matjes së gjobës KVK i merr parasysh këto rrethana lehtësuese:

- Komisioni me aktvendimin nr. 08-1 të datës 25.02.2025, konstatoi se përqendrimi i theksuar është në përputhje me dispozitat e Ligjit, prandaj Prandaj me zbatimin e përqendrimit nuk është cenuar konkurrenca dhe nuk janë shkaktuar pasoja ndaj konkurrencës në tregun relevant;
- Korporata Jageo deri te Komisioni dorëzoi njoftim për përqendrim më 02.01.2025 dhe të njëjtin e plotësoi më 29.01.2025 dhe
- Korporata Jageo efektivisht bashkëpunoi me KVK-në gjatë procedurës.

Në bazë të kësaj që u theksua më lart KVK konstatoi se Korporata Jageo si ndërmarrje e cila ka fituar kontroll mbi Korporatën KEMET, edhe pse në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ka qenë e obliguar që Komisionit t'i dorëzojë njoftim për përqendrim para zbatimit të tij respektivisht para 15.06.2020, kur është dorëzuar Vërtetim për bashkim te Sekretari i shtetit, ndërsa pas lidhjes së Marrëveshjes dhe planit për bashkim më 11 nëntor 2019, e njëjta në periudhën e theksuar nuk ka parashtruar njoftim për përqendrim, me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 60 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për çka i shqiptohet sanksion - gjobë në shumë prej 307.500 denarë që paraqet 0,0004% nga vlera e të ardhurave të përgjithshme vjetore të Korporatës Jageo të realizuara në vitin 2019 (të llogaritura në përputhje me nenin 16 të Ligjit) si vit i cili i paraprin përqendrimit.

Në përputhje me nenin 18 paragrafi (1) të Ligjit, përqendrimi nuk guxon të zbatohet as para se të jetë parashtruar njoftim për të njëjtin deri te Komisioni, as pas parashtrimit të njoftimit, derisa të mos sillet aktvendim se përqendrimi është në përputhje me dispozitat e Ligjit. KVK konstatoi se përqendrimi është zbatuar para se të jetë parashtruar njoftimi deri te Komisioni dhe pa u

sjellë aktvendim nga Komisioni, respektivisht Korporata Jageo ka vepruar në kundërshtim me nenin 18 paragrafi (1) të Ligjit.

Zbatimi i përqendrimit në kundërshtim me nenin 18 paragrafi (1) të Ligjit paraqet kundërvajtje nga neni 60 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

KVK konstatoi se kohëzgjatja e kundërvajtjes nga neni 60 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit është nga 15.06.2020, kur është dorëzuar Vërtetimi për bashkim të Sekretari i shtetit deri më 25.02.2025 si ditë kur është sjellë aktvendimi nr. 08-1 me të cilin konstatohet se përqendrimi lëndor është në përputhje me Ligjin. Në bazë të kësaj periudha në të cilën ka zgjatur kundërvajtja është 4 vjet e 8 muaj.

Për kundërvajtjen e kryer Korporatës Jageo do t'i shqiptohet sanksion për kundërvajtje – gjobë në shumë deri në 10% nga vlera e të ardhurave të përgjithshme vjetore të realizuara në vitin afarist që i paraprin përqendrimit i llogaritur në përputhje me nenin 16 të Ligjit, *respektivisht e ardhura e përgjithshme e cila përbëhet nga shumat e realizuara me shitjen e mallrave të prodhuara në punën e rregullt të ndërmarrjes, si dhe nga shumat nga shërbimet që ndërmarrja i jep në punën e saj të rregullt, ndërsa të realizuara në vitin afarist që i paraprin përqendrimit, pas zbritjes së rabateve (zbritjeve) të shitjes dhe tatimit mbi vlerën e shtuar dhe detyrimeve tjera publike të lidhura drejtpërdrejt me të ardhurat. Nëse njëri nga pjesëmarrësit është ndërmarrje e lidhur në kuptim të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, gjatë llogaritjes së të ardhurave të tij të përgjithshme, të gjitha ndërmarrjet që janë të lidhura në atë mënyrë do të trajtohen si një ndërmarrje, me ç'rast kur llogariten të ardhurat e përgjithshme të ndërmarrjeve të lidhura nuk do të merren parasysh shumat e realizuara nga shitjet e mallrave dhe/ose dhënia e shërbimeve ndërmjet tyre.*

Të ardhurat e përgjithshme të Korporatës Jageo të realizuara në vitin 2019 (të llogaritura në përputhje me nenin 16 të Ligjit) si vit i cili i paraprin përqendrimit arrijnë shumën prej 1,197,552,391 euro respektivisht 73.625.521.000 denarë.

Në përcaktimin e shumës së gjobës, në përputhje me nenin 64 të Ligjit, KVK i merr parasysh peshën e kundërvajtjes, kohëzgjatjen e kundërvajtjes dhe shkallën e cenimit të konkurrencës dhe pasojat e shkaktuara nga kundërvajtja.

Gjatë matjes së gjobës KVK i merr parasysh këto rrethana lehtësuese:

- Komisioni me aktvendimin nr. 08-1 të datës 25.02.2025, konstatoi se përqendrimi i theksuar është në përputhje me dispozitat e Ligjit, prandaj Prandaj me zbatimin e përqendrimit nuk është cenuar konkurrenca dhe nuk janë shkaktuar pasoja ndaj konkurrencës në tregun relevant;
- Korporata Jageo deri te Komisioni dorëzoi njoftim për përqendrim më 02.01.2025 dhe të njëjtin e plotësoi më 29.01.2025 dhe
- Korporata Jageo efektivisht bashkëpunoi me KVK-në gjatë procedurës.

Në bazë të kësaj që u theksua më lart KVK konstatoi se Korporata Jageo si ndërmarrje e cila ka fituar kontroll mbi Korporatën KEMET, edhe pse në përputhje me nenin 18 paragrafi (1) të Ligjit nuk ka guxuar ta zbatojë përqendrimin para datës 25.02.2025, si ditë kur Komisioni ka sjellë aktvendim me të cilin konstatohet se përqendrimi lëndor është në përputhje me Ligjin, Korporata Jageo e ka zbatuar përqendrimin më 15.06.2020, kur është dorëzuar Vërtetim për bashkim të Sekretari i shtetit, me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 60 paragrafi (1) pika 2) të

Ligjit për çka i shqiptohet sanksion - gjobë në shumë prej 3.444.000 denarë që paraqet 0,0046% nga vlera e të ardhurave të përgjithshme vjetore të Korporatës Jageo të realizuara në vitin 2019 (të llogaritura në përputhje me nenin 16 të Ligjit) si vit i cili i paraprin përqendrimit.

Në përputhje me nenin 27 paragrafi (1) të Ligjit për kundërvajtjet - Nëse kryerësi me një veprim ose me më shumë veprime ka kryer më shumë kundërvajtje, por nuk është sjellë vendim për kundërvajtje, paraprakisht do të përcaktohet sanksioni për çdo kundërvajtje të veçantë, ndërsa pastaj do të shqiptohen si sanksion i vetëm të gjitha sanksionet e përcaktuara ashtu.

Në përputhje me nenin 27 paragrafi (2) të Ligjit për kundërvajtjet - Nëse për më shumë kundërvajtje të kryera në bashkim është përcaktuar gjobë do të shqiptohet sanksion i vetëm që është i barabartë me shumën e gjobës së përcaktuar veçmas, e cila nuk mund ta tejkalojë maksimumin ligjor të gjobës së paraparë me ligj.

Prandaj, KVK, në përputhje me nenin 27 të Ligjit për kundërvajtjet, Korporatës Jageo i shqipton sanksion të vetëm në shumë prej 3.751.500 denarë, që paraqet 0,005% nga vlera e të ardhurave të përgjithshme vjetore të Korporatës Jageo të realizuara në vitin 2019 si vit i cili i paraprin përqendrimit.

KVK nuk e pranon qëndrimin e Korporatës Jageo se në lëndën konkrete ekziston kundërvajtje vetëm nga neni 60 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit, respektivisht se nuk ekziston kundërvajtje nga neni 60 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit, sepse kundërvajtje nga neni 60 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit ekziston vetëm kur është parashtruar njoftim por përqendrimi është zbatuar para sjelljes së aktvendimit nga Komisioni.

Gjegjësisht KVK thekson se është e saktë se nëse përqendrimi është zbatuar para se të parashtrohet njoftimi, kjo do të thotë edhe se është zbatuar para se Komisioni të sjellë aktvendim për miratimin/mosmiratimin e përqendrimit. Megjithatë Ligji nuk bën hierarki ndërmjet këtyre dy kundërvajtjeve dhe parashikon shqiptimin e gjobës së ndarë për secilën nga kundërvajtjet e theksuara. Gjegjësisht neni 15 paragrafi (1) dhe neni 18 paragrafi (1) i Ligjit paraqesin dispozita të pavarura, njëra parasheh obligim për veprim, ndërsa tjetra parasheh obligim për mosveprim.

Ligji për Mbrojtjen e Konkurrencës është harmonizuar me Rregulloren e Këshillit të Komisionit Evropian nr. 139/2004 dhe në përputhje me nenin 3 paragrafi (3) të Ligjit "Në vlerësimin e formave të cenimit të konkurrencës të cilat mund të kenë ndikim në tregtinë ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Komuniteteve Evropiane, në përputhje me nenin 69 të Marrëveshjes për stabilizim dhe asociim ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Komuniteteve Evropiane dhe vendeve të saj anëtare, në mënyrë përkatëse zbatohen kriteret të cilat dalin nga zbatimi i drejtë i rregullave për konkurrencën në Bashkimin Evropian". Në rastin konkret KVK u udhëhoq ndër të tjera edhe nga Aktgjykimi i Gjykatës së Drejtësisë në lëndën C-10/18P të datës 4.03.2020².

Për shkak të të gjitha këtyre që u theksuan më lart u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

² Vendim i Gjykatës së Drejtësisë në çështjen C-10/18 P, i datës 4.03.2020 (Judgment of the Court (Fourth Chamber) of 4 March 2020 in Case C-10/18 P, - Mowi ASA (Formerly Marine Harvest ASA) vs European Commission

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicimin e kontestit administrativ para gjykatës kompetente në afat prej tetë (8) ditësh nga dita e pranimi të këtij aktvendimi. Padia e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

**KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
KOMISIONI PËR VENDIMMARRJE PËR KUNDËRVAJTJTE
KRYETAR
Mr. Борче Размоски**